

DHOMA E POSAÇME E
GJYKATËS SUPREME TË
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË
LIDHEN ME AGJENCINË
KOSOVARE TË
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE
SUPREME COURT OF KOSOVO
ON KOSOVO TRUST AGENCY
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA
VRHOVNOG SUDA
KOSOVA ZA PITANJA
KOJA SE ODNOSE NA
KOSOVSKU
POVERENIČKU AGENCIJU

ASC-09-0049

Në padinë e

1. [REDACTED] Ferizaj

Ruga [REDACTED] Ferizaj

2. [REDACTED] Altindag, Turqi

3. [REDACTED] Izmir, Turqi, dhe

4. [REDACTED] Turqi

1, 3, dhe 4. të përfaqësuar nga [REDACTED],

Ruga [REDACTED], Ferizaj

Paditësit

Kundër

**KBI "Kosova Export",
Kooperativa Bujqësore Prishtinë**

Fushë Kosovë

E paditura

Kolegji i Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Eija-Liisa Helin, Gjyqtarë, në lidhje me ankesën e paditësve 1, 3 dhe 4 kundër aktvendimit të

DHPGJS-së të datës 9 korrik 2009, SCC-08-0071, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 12 nëntor 2009, lëshon këtë:

A K T V E N D I M:

Ankesa hidhet poshtë si e papranueshme.

Arsyet Ligjore:

Në padinë e tyre të datës 12 shkurt 2008, të ushtruar pranë Dhomës së Posaçme, katër Paditësit kërkojnë njohjen e të drejtave të pronësisë në lidhje me parcela të caktuara të tokës; në të njëjtën kohë ata parashtruan një kërkesë për ndalim të përkohshëm për të ndaluar të Paditurën nga "privatizimi" i tokës.

Me Aktvendim të datës të 9 korrik 2009, SCC-08-0071, Trupi Gjykues ka refuzuar kërkesën për ndalim të përkohshëm si të papranueshëm, mbi bazën se Paditësit nuk kanë ofruar prova të besueshme në lidhje me kushtet e parashtruara në Nenin 55.1 të UA të UNMIK 2008/6 për lëshimin e ndalimit të përkohshëm (dëmi, humbja apo dëmtimi i drejtpërdrejtë dhe i pariparueshëm).

Aktvendimi iu është dorëzuar Paditësve më 16 korrik 2009.

Në ankesën e dorëzuar më 17 gusht 2009 (e hëne) pranë DHPGJS-ës, vetëm në gjuhën shqipe, i është kërkuar Dhomës së Posaçme (Apelit të Ankesave) që të kthej vendimin e atakuar dhe të lëshojë ndalimin e përkohshëm, ashtu siç është i aplikuar. Në ankesë, nuk precizohet nëse ajo është depozituar në emër të Paditësve; emri i Paditësit nr. 2 nuk është përmendur me këtë rast.

Me Urdhër të datës 4 shtator 2009, të dorëzuar pranë përfaqësuesve të Paditësve më 23 shtator 2009, Paneli i Ankesave kërkon nga ta që të dorëzojnë brenda 14 ditëve një kopje të aktvendimit të atakuar, ankesën e

përkhysen në gjuhën angleze, dhe një sqarim nëse ankesa është depozituar në emrat e të gjithëve, me përjashtim të Paditësit të dytë apo në emër të të gjithë Paditësve. Në Urdhër Paditësit janë njoftuar në lidhje me pasojat në rast se nuk pajtohen me të në kohë.

Me 12 tetor 2009 një kopje e aktvendimit të atakuar, dhe ankesa në anglisht, janë dorëzuar personalisht pranë Dhomës së Posaqme.

Ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme.

Sipas Nenit 28.4 të UA të UNMIK-ut 2008/6, nëse Paditësi, pasi të ketë ushtruar një padi, e cila nuk i plotëson kushtet e parashtruara në nenet 25, 27 në lidhje me 28.2 paragrafi (f) të UA të UNMIK-ut 2008/6, nuk arrin të parashtrojë një ankesë të kompletuar apo të korrigjuar e që i plotëson kërkesat brenda afatit të përcaktuar në një urdhër që do t'i dorëzohet atij, apo të ofrojë dokumentet e kërkura, brenda afatit të përcaktuar në urdhër, atëherë Trupi Gjyqes do të refuzojë padinë mbi bazat e papranueshmërisë.

Këto dispozita aplikohen *mutatis mutandis* ndaj procedurës në Panelin e Ankesave (Nenet 58.2 dhe 61.4 të UA të UNMIK-ut 2008/6), duke nënkuptuar se mos parashtrimi i një ankesë të tillë brenda afatit të përcaktuar kohor do të rezultojë në refuzimin e tij si të papranueshëm. Kur mungojnë kushtet formale dhe substanciale të një ankesë, dhe urdhri për të kompletuar atë nuk zbatohet në përputhje me rr Ethanat, atëherë ankesa duhet të refuzohet si e papranueshme (shiko p.sh., *Kodek in Rechberger ZPO³* pp 1499 [Vienna 2006]).

Paditësit nuk janë përgjigjur ndaj urdhrit të Panelit të Ankesave të datës 4 shtator 2009 brenda afatit të përcaktuar aty. Si shësë, nuk është adresuar fare kërkesa për të sqaruar pyetjen se në emër të kujt është ushtruar ankesa. Prandaj, ankesa, e cila duhet të konsiderohet se është parashtruar vetëm nga Paditësit 1, 3 dhe 4, është e papranueshme.

Një vendim në lidhje me shpenzimet nuk është paraparë që të merret.

Trupi Gjykues do të duhet të merret me padinë tanë.

Richard Winkelhofer, EULEX Gjyqtar Kryesues nënshtuar

Torsten Frank Koschinka, EULEX Gjyqtar nënshkruar

Eija-Liisa Helin, EULEX Gjyqtare nënshtuar

Tobias Lapke, EULEX Regjistrues Ndërkombeṭar nënshkruar